

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore

1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.
4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar

Constitutional Paragraph: Neni 55.1

1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.

Instrumentet ndërkombëtare

Nenet

Neni 12.3

Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike

3. Të drejtat e sipërmendura mund të kufizohen vetëm kur kjo parashikohet me ligj, dhe kur është e nevojshme për të mbrojtur sigurinë kombëtare, rendin publik, shëndetin ose moralin publik ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve, si dhe kur kërtohet kufizime janë përputhje me të drejtat e tjera të njohura në këtë Pakt.

Instrumentet ndërkombëtare

Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike

Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike

Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike

Nenet

Neni 19.3

3. Ushtrimi i lirisë të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t'u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme:

(a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve;

(b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.

Neni 4

1. Në kohën kur një rrezik publik i jashtëzakonshëm kërcënon ekzistencën e kombit dhe shpallet zyrtarisht si i tillë, shtetet palë të këtij Pakti mund të marrin masa me të cilat shmangen detyrimet e parashikuara në këtë Pakt, në vëllimin përpikërisht të caktuar sipas kërkesave të situatës, me kusht që këto masa të mos jenë në mosprerë me detyrimet e tyre të tjera sipas të drejtës ndërkombëtare dhe të mos ngatërrojnë, si pasojë, një diskriminim të bazuar vetëm në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, ose origjin shoqëror.

2. Asnjë shmangie nga nenet, 6, 7, 8, (par. 1 dhe 2), 11, 15, 16, dhe 18 nuk mund të bëhet sipas kësaj dispozite.

3. Shtetet palë të këtij Pakti që shfrytëzojnë të drejtën e shmangies, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i njoftojnë menjëherë shtetet e tjera palë të këtij Pakti lidhur me dispozitat nga të cilat ato janë shmangur si dhe lidhur me arsyet që i kanë shtyrë të bëjnë këtë shmangie. Me ndërmjetësimin e njëjtë bëhet një kumtim i mëtejshëm lidhur me datën kur këto shtete do t'u japin fund këtyre shmangieve.

Neni 5

1. Asnjë dispozitë e këtij Pakti nuk mund të interpretohet asisoj sikur i njeh një shteti, një grupi ose një personi çfarëdo të drejtë për të zhvilluar ndonjë veprimtari ose për të kryer një veprim që synon shkeljen e të drejtave dhe lirisë të njohura në këtë Pakt ose kufizimin e tyre në një shkallë më të gjerë se sa parashikohet me këtë Pakt.

2. Nuk lejohet asnjë kufizim ose shmangie nga cilatdo të drejta themelore të njeriut që janë të njohura ose që janë në fuqi në ndonjë shtet palë të këtij Pakti në përputhje me ligjet, konventat, aktet ose zakonet e tjera me pretekstin se ky Pakt nuk i njeh ose i njeh në një shkallë më të vogël.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike

Neni 22.2

2. Ushtrimi i kësaj të drejte mund të jetë objekt vetëm i kufizimeve që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, qetësisë dhe rendit publik, ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik apo të drejtat dhe liritë e të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizimet ligjore për ushtrimin e kësaj të drejte nga autoritetet e forcave të armatosura dhe të policisë.

Konventa Evropiane për
Mbrojtjen e të Drejtave dhe
Lirive Themelore të Njeriut
dhe Protokollet e saj
Konventa Evropiane për
Mbrojtjen e të Drejtave dhe
Lirive Themelore të Njeriut
dhe Protokollet e saj

NENI 18

Kufiri i zbatueshmërisë së kufizimeve të të drejtave Kufizimet e lejuara sipas kësaj Konvente ndaj të drejtave dhe lirive të sipërpërmendura nuk do të zbatohen për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë parashikuar.

Neni 10.2

Konventa Evropiane për
Mbrojtjen e të Drejtave dhe
Lirive Themelore të Njeriut
dhe Protokollet e saj
Konventa Evropiane për
Mbrojtjen e të Drejtave dhe
Lirive Themelore të Njeriut
dhe Protokollet e saj

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Neni 29.

1. Secili ka detyrime ndaj bashkësisë ku vetëm aty i mundësohet zhvillimi i lirë dhe i plotë i personalitetit të tij.

Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut

2. Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të veta, secili do t'u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë përcaktuar me ligj, vetëm me qëllim të sigurimit të njohjes dhe të respektimit të domosdoshëm të të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe të plotësisë së kërkesave të drejta të moralit, të rendit publik dhe të mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike.

3. Këto të drejta dhe liri kurrsesi nuk mund të ushtrohen në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Neni 15

Konventa për të Drejtat e
Fëmijës

1. Shtetet Palë njohin të drejtat e fëmijës për lirinë e organizimit dhe lirinë e grumbullimit paqësor.

Konventa për të Drejtat e
Fëmijës

2. Asnjë kufizim nuk mund të ketë në ushtrimin e këtyre të drejtave, përveç atyre të përcaktuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurimit kombëtar, të sigurisë publike ose të rendit publik, ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik, ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Ligjet

Nenet

Neni 5

KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

Kufizimet në ekzekutimin e sanksioneve penale dhe masave të trajtimit të detyrueshëm Me ekzekutimin e sanksionit penal ose masës së trajtimit të detyrueshëm, kryesit të veprës penale mund ti kufizohen të drejtat e caktuara vetëm deri në atë masë e cila i përgjigjet natyrës apo përmbajtjes së sanksionit ose masës dhe vetëm në mënyrën me të cilën sigurohet respektimi i dinjitetit njerëzor të tij apo saj, në pajtim me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 18.4

4. DSHAM, mund ta ndalojë aplikuesin në Qendrën e Mbajtjes në rastet kur konsideron të nevojshme dhe në bazë të një vlerësimi individual të secilit rast, dhe në qoftë se me masa të tjera alternative më pak shtrënguese alternative nuk mund të arrihet qëllimi i kufizimit të lirisë së lëvizjes, në rastet e mëposhtme:

4.1. për të përcaktuar ose verifikuar identitetin apo shtetësinë e tij/saj;

4.2. për të përcaktuar elementet në të cilat është bazuar aplikacioni për mbrojtje ndërkombëtare, e që nuk do të mund të siguroheshin pa kufizimin e lirisë së lëvizjes, sidomos kur ekziston rreziku i ikjes së aplikuesit;

4.3. kur është e nevojshme për mbrojtjen e sigurisë kombëtare ose sigurisë publike;

4.4. për të vendosur, në kontekst të procedurës, për të drejtën e aplikuesit për të hyrë në territor;

4.5. kur ai ose ajo mbahet për qëllime të procedurës së kthimit, për të përgatitur kthimin dhe/ose kryer procesin e largimit, dhe kur organi kompetent mund të dëshmojë në bazë të kritereve objektive, përfshirë edhe faktin se parashtruesi ka pasur tashmë mundësinë për të filluar procedurën e mbrojtjes ndërkombëtare, se ka baza të arsyeshme për të besuar se personi po aplikon për mbrojtje ndërkombëtare vetëm sa për ta shtyrë ose penguar ekzekutimin e vendimit për kthim.

Ligji nr. 06/l- 026 për azil

Ligji nr. 06/l- 026 për azil

Ligjet

Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës dhe LIGJI NR. 06/L-077 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS
Ligji nr. 2004/32 për familjen i Kosovës dhe LIGJI NR. 06/L-077 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS

Fshi LIGJI NR. 04/L-149
LIGJI NR. 04/L-149

Fshi LIGJI NR. 04/L-149
LIGJI NR. 04/L-149

Nenet

Neni 149.

Privimi nga Kujdesi

- (1) Prindërit të cilët e keqpërdorin ushtrimin e të drejtës prindërore ose në mënyrë serioze e neglizhojnë ushtrimin e të drejtës prindërore, privohen nga Kujdesi.
- (2) Prindi mund të privohet nga kujdesi për të gjithë fëmijët, e nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e posaçme, ata privohen nga kujdesi vetëm ndaj njërit fëmijë.
- (3) Vendimin mbi privimin e prindërve nga kujdesi prindëror e merr gjykata kompetente në procedurë jashtëkontestimore pasi të ketë marrë mendimin nga Organi i Kujdestarisë dhe pasi të ketë hetuar të gjitha rrethanat relevante lidhur me rastin individual.

Neni 58.4

4. Personit të dënuar i mundësohet të jetë i pranishëm gjatë hapjes së letrës, ose dërgesës tjetër postare dërguar atij, ose nga ai në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni. Në rastin kur ai nuk është i pranishëm informohet menjëherë. Kur hapja e letrës, ose e dërgesës tjetër postare bëhet në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni, përmbajtja e tyre kontrollohet vetëm në masën e nevojshme për nxjerrjen e konstatimit, nëse letra, ose dërgesa tjetër postare përmban ndonjë send të palejuar

Neni 59.2

2. Përrjashtimisht, kolegji i përbërë nga tre (3) gjyqtarë të gjykatës themelore kompetente mund të nxjerrë aktvendim me kërkesë të drejtorit të institucionit korrektuese që:

2.1. korrespondenca e personit të dënuar me avokatin e tij të mund të hapet, nëse plotësohen kushtet nga paragrafi 3 i nenit 58 i këtij ligji. Në rastin e tillë zbatohet paragrafi 4 i nenit 58 të këtij ligji;

2.2. drejtori i institucionit korrektues mund të hapë dhe të lexojë korrespondencën e personit të dënuar me avokatin e tij, nëse plotësohen kushtet e paraqitura në paragrafin 5 të nenit 58 të këtij ligji. Në rastin e tillë zbatohet paragrafi 6.i nenit 58 të këtij ligji.

Ligjet

Fshi LIGJI NR. 04/L-149
LIGJI NR. 04/L-149

Ligji për Policinë Nr. 04/L-076
Ligji për Policinë Nr. 04/L-076

Ligji për Policinë Nr. 04/L-076
Ligji për Policinë Nr. 04/L-076

Nenet

Neni 60.2

E drejta në thirrje telefonike

2. Dispozitat e nenit 58 të këtij ligji përshtatëshmërisht aplikohen edhe për mbikqyrje të thirrjeve telefonike.

Neni 18

Kufizimi i përkohshëm i lirisë së lëvizjes

1.Zyrtari policor është i autorizuar që përkohësisht t'ia kufizojë lirinë e lëvizjes personit në një zonë të caktuar ose ta orientojë lëvizjen e tij në një zonë tjetër, me qëllim që të sigurohet zona e caktuar për t'i arritur objektivat legjitime të policisë apo për t'i mbrojtur personat nga rreziku i përkohshëm.

2.Objektivat legjitime të policisë përfshijnë, por nuk kufizohen në mbrojtjen e personave nga fatkeqësitë, epidemitë, dhe rastet e tjera të rrezikut të pashmangshëm.

3.Kufizimi i përkohshëm i lirisë së lëvizjes të personit përfundon menjëherë pasi të arrihen objektivat legjitime të policisë lidhur me kufizimin e përkohshëm.

Neni 5

1Gjykata do t'i jep mundësi secilës palë që të deklarohet rreth kërkesave dhe thënieve të palës kundërshtare.

2 Vetëm në rastet e përcaktuara me këtë ligj gjykata ka drejtë që të vendos mbi kërkesën për të cilën palës kundërshtare nuk i është dhënë mundësia që të deklarohet.

Ligjet

Ligji Nr. 05/L -031 PËR
PROCEDURËN E
PËRGJITHSHME
ADMINISTRATIVE
Ligji Nr. 05/L -031 PËR
PROCEDURËN E
PËRGJITHSHME
ADMINISTRATIVE

Nenet

Neni 5

Neni 5

1. Një veprim administrativ, që për arsye të mbrojtjes së interesit publik kufizon apo cenon të drejtat apo interesat juridike të një personi, duhet të jetë në pajtim me parimin e proporcionalitetit.
2. Një veprim administrativ është në pajtim me parimin e proporcionalitetit vetëm nëse i plotëson këto kushte:
 - 2.1. është i domosdoshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj;
 - 2.2. është i përshtatshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj, dhe
 - 2.3. kufizimi apo cenimi i të drejtës apo interesit juridik nuk është në shpërpjestim me realizimin e qëllimit të ndjekur.

Ligjet

Nenet

Neni 17.2

2. Kufizimi i të drejtës për qasje në dokumente publike ushtrohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit sipas ligjit përkatës për Procedurën e përgjithshme administrative, në përputhje me këtë ligj dhe vetëm për qëllime të mbrojtjes së:

2.1. jetës, shëndetit dhe të sigurisë publike;

2.2. sigurisë shtetërore, mbrojtjes dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare;

2.3. parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale në rastet kur publikimi i dokumenteve publike mund të dëmtojë procesin e hetimit;

2.4. hetimet disiplinore, në rastet kur publikimi i dokumenteve publike mund të dëmtojë procedurën disiplinore;

LIGJI NR. 06/L-081 PËR QASJE
NË DOKUMENTE PUBLIKE
LIGJI NR. 06/L-081 PËR QASJE
NË DOKUMENTE PUBLIKE

2.5. inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike në rastet kur trajtojnë informacion të klasifikuar;

2.6. të drejtës për privatësi dhe e drejta e fshirjes ('E drejta për t'u harruar');

2.7. konfidencialitetit komercial siç janë sekretet e biznesit, sekretet profesionale apo të kompanisë;

2.8. dokumenteve për të cilat institucioni publik apo palët e treta gëzojnë të drejtat e pronësisë intelektuale;

2.9. politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit;

2.10. konfidencialitetit statistikor;

2.11. barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë;

2.12. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje, e cila përbën dokument të klasifikuar.

Neni 4.1

Kufizimet dhe ndalimet e tubimeve publike

LIGJI Nr. 03/L-118 PËR
TUBIMET PUBLIKE
LIGJI Nr. 03/L-118 PËR
TUBIMET PUBLIKE

1. Me këtë ligj rregullohen tubimet publike, caktohen kufizime apo ndalohen tubimet publike kur ato rrezikojnë rendin, qetësinë dhe sigurinë publike, sa i përket lirisë, dhe të drejtave të njerëzve të tjerë, moralit dhe shëndetit publik.

Ligjet

LIGJI Nr. 03/L-118 PËR
TUBIMET PUBLIKE
LIGJI Nr. 03/L-118 PËR
TUBIMET PUBLIKE

LIGJI NR.08/L-111 PËR
ARKIVAT
LIGJI NR.08/L-111 PËR
ARKIVAT

Nenet

Neni 8 1.

Policia e Kosovës mund të ndalojnë një tubim të qetë publik kur konsiderojnë se:

- 1.1. tubimi publik nuk është lajmëruar në mënyrë të rregullt;
 - 1.2. është paraparë të mbahet në vendin që është ndaluar me këtë ligj;
 - 1.3. kur qëllimet e tubimit nxisin ose thërrasin për përdorimin e dhunës, urrejtës ndërnacionale, fetare racore, politike;
 - 1.4. se ekzistojnë arsye të konsiderueshme se tubimi do të mund të përdorej për dhunë.
2. Tubimi publik sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të ndalohet së paku njëzetekatër (24) orë para se të mbahet.
3. Organizatori apo lajmëruesi i tubimit publik i pakënaqur me vendimin e organit që ka ndaluar tubimin publik mund brenda tri (3) ditëve të ankohet para gjykatës kompetente për shqyrtim të rastit.
4. Gjykata në këtë rast vendos me procedurë të shpejtuar.
5. Tubimi spontan pa organizator të njohur i cili rrezikon të eskaloj në tubim të dhunshëm është i ndaluar.

Neni 12. 2.

Neni 12 Shfrytëzimi i materialit arkivor

2. Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës në materialin e arkivuar në Agjenci, me përjashtim të kufizimeve të cilat parashihen me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Ligjet

LIGJI NR.08/L-111 PËR
ARKIVAT
LIGJI NR.08/L-111 PËR
ARKIVAT

LIGJI PËR SHËNDETIN
MENDOR Nr. 05/L -025
LIGJI PËR SHËNDETIN
MENDOR Nr. 05/L -025

LIGJI PËR SHËNDETIN
MENDOR Nr. 05/L -025
LIGJI PËR SHËNDETIN
MENDOR Nr. 05/L -025

Nenet

Neni 12. 6

Neni 12. 6. Shfrytëzimi i materialit arkivor mund të kufizohet në tërësi apo pjesërisht në këto raste:

6.1. kur ekziston dyshimi se do të rrezikohet mirëqenia e Republikës së Kosovës;

6.2. kur cenohet siguria kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;

6.3. kur cenohet jeta private e individit;

6.4. kur cenohen të drejtat themelore të personave të tretë të garantuara me legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale;

6.5. kur cenohet politika financiare, monetare ose tatimore e shtetit të Republikës së Kosovës;

6.6. çfarëdo dokumenti në përkujdesje të arkivave të Kosovës që përmban informata ose të dhëna që mund t'i prekin të drejtat dhe liritë fundamentale njëzore të garantuara me Konventën Europiane për të drejtat e njeriut.

Neni 6.2

6.2. Ushtrimi i të drejtave të personave me çrregullime mendore mund të kufizohet vetëm në rastet e parashikuara me dispozitat ligjore në fuqi. Këto kufizime varen nga gjendja shëndetësore e klientit dhe nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me Konventat ndërkombëtare të pranuar nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Neni 9.1

1. Heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar i personave me çrregullime mendore është e ndaluar, përveç rasteve të parashikuara me dispozitat ligjore në fuqi. Në raste të veçanta kjo masë mund të propozohet me kërkesë të komisionit psikiatriko - ligjor. Vendimi përkatës merret nga gjykata, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Ligjet

Ligji Nr.2004/38 PËR TË
DREJTAT DHE
PËRGJEGJËSITË E
BANORËVE TË KOSOVËS NË
SISTEMIN SHËNDETËSOR
Ligji Nr.2004/38 PËR TË
DREJTAT DHE
PËRGJEGJËSITË E
BANORËVE TË KOSOVËS NË
SISTEMIN SHËNDETËSOR

Ligji Nr.2004/38 PËR TË
DREJTAT DHE
PËRGJEGJËSITË E
BANORËVE TË KOSOVËS NË
SISTEMIN SHËNDETËSOR
Ligji Nr.2004/38 PËR TË
DREJTAT DHE
PËRGJEGJËSITË E
BANORËVE TË KOSOVËS NË
SISTEMIN SHËNDETËSOR

KODI NR. 08/L-032 I
PROCEDURËS PENALE
KODI NR. 08/L-032 I
PROCEDURËS PENALE

KODI NR. 08/L-032 I
PROCEDURËS PENALE
KODI NR. 08/L-032 I
PROCEDURËS PENALE

Nenet

Neni 6.3

6.3. Gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore, qytetarit mund t'i kufizohet ushtrimi i të drejtave, vetëm për periudhën e kohës, në masën dhe në mënyrën e përcaktuar me ligj, kushtëzuar nga gjendja shëndetësore e tij.

Neni 6.4.

6.4. Gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore, liria personale e qytetarit mund të kufizohet me metoda ose procedura fizike, kimike, biologjike ose psikologjike, vetëm në rastet e emergjencës, ose në interesin e jetës, të sigurisë fizike dhe të shëndetit të qytetarit ose të të tjerëve, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Kufizimet e qytetarit nuk guxojnë të jenë të natyrës dënuese dhe mund të zgjasin vetëm për periudhën kohore gjatë së cilës ekziston shkak për të cilin janë urdhëruar ato.

Neni 12

Ligjshmëria e privimit nga liria dhe vendosja në procedurë të përshpejtuar

1. Askujt nuk mund t'i hiqet apo kufizohet liria, përpos rasteve dhe në pajtim me procedurën e përcaktuar me ligj. 2. Çdo person i privuar nga liria me arrest ose me ndalim, ka të drejtë të kundërshtojë, sipas procedurës së paraparë me këtë Kod, ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit të tij, për të cilën vendos gjykata në procedurë të përshpejtuar ose urdhëron lirimin e tij kur ndalimi është i paligjshëm.

Neni 17

Fillimi dhe kohëzgjatja e pasojave që kufizojnë të drejtat Kur dihet se fillimi i procedurës penale ka për pasojë kufizimin e disa të drejtave të caktuara dhe kur procedura penale zhvillohet për ndonjë vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me më shumë se tre (3) vjet burgim, pasoja e tillë hyn në fuqi nga momenti i konfirmimit të aktakuzës, po qe se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Nëse procedura penale zhvillohet për ndonjë vepër penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë ose dënim me burgim deri në tre (3) vjet, pasoja e tillë hyn në fuqi nga dita kur aktgjykimi dënues merr formë të prerë, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.

Korrespondenca

1. Personi i dënuar gëzon të drejtën për korrespondencë .
2. Personi i dënuar gëzon të drejtën e privatësisë së letrave dhe mjeteve të tjera të komunikimit.
3. Letra, ose dërgesa tjetër postare mund të hapet nëse ekziston dyshim i bazuar se në të gjendet ndonjë send i palejuar.
4. Personit të dënuar i mundësohet të jetë i pranishëm gjatë hapjes së letrës, ose dërgesës tjetër postare dërguar atij, ose nga ai në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni. Në rastin kur ai nuk është i pranishëm informohet menjëherë. Kur hapja e letrës, ose e dërgesës tjetër postare bëhet në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni, përmbajtja e tyre kontrollohet vetëm në masën e nevojshme për nxjerrjen e konstatimit, nëse letra, ose dërgesa tjetër postare përmban ndonjë send të palejuar.
5. Drejtori i institucionit korrektues mund të nxjerrë vendim me shkrim për autorizimin e hapjes, a leximit të letrës, ose dërgesës tjetër postare si masë më së paku shqetësuese e mundshme nëse ekziston dyshim i bazuar se në të ka prova për: 5.1. veprim që do të rrezikonte sigurinë e institucionit korrektues, ose të ndonjë personi; 5.2. veprë penale, apo plan për kryerjen e veprës penale, dhe 5.3. hapja e leximi i letrës, ose i dërgesës postare është masa më së paku e bezdisshme e mundshme në ato rrethana.
6. Kur letra, ose dërgesa tjetër postare hapet dhe lexohet në pajtim me paragrafin 5. të këtij neni, drejtori i institucionit korrektues menjëherë e informon me shkrim personin e dënuar lidhur me arsyet e veprimit të tillë dhe atij i mundëson dhënien e sqarimeve lidhur me këtë, përveç nëse informata pafavorshëm do të ndikonte në hetimet e papërfunduara, me ç'rast personi i dënuar informohet për arsyet dhe atij i mundësohet dhënia e sqarimeve lidhur me këtë me përfundimin e hetimeve.
7. Letra, ose dërgesa postare që është hapur dhe lexuar në pajtim me paragrafin 5. të këtij neni mund të ndalohej, nëse do të rrezikohej siguria e institucionit korrektues, ose e ndonjë personi. Në rastin e tillë personi i dënuar informohet menjëherë dhe, në rastin e ndalimit të letrës, ose të dërgesës postare pasuese, ai informohet për përmbajtjen e saj deri në masën e nevojshme. Letra që është ndaluar i dorëzohet personit të dënuar sapo të pushojë së ekzistuari baza për ndalimin e saj dhe më së voni deri në fund të mbajtjes se dënimit të tij, përveç nëse gjykata kompetente vendos ndryshe. Kundër vendimit të gjykatës, lejohet ankesë në gjykatën kompetente. Ankesa nuk e shtyen ekzekutimin e vendimit.
8. Letrat dhe dërgesat tjera postare nga personi i dënuar që i adresohen Avokatit të Popullit nuk kontrollohen.

decisionTitle***decisionDescription***

MERABISHVILI v. GEORGIA(Application no. [72508/13](#)) 28 November 2017

MERABISHVILI v.
GEORGIA(Application
no. 72508/13) 28
November 2017

Aplikuesi ka lindur në vitin 1968 dhe ishte është në paraburgim në Tbilisi. Pas të ashtuquajturit "Rose Revolution", që u zhvillua në vitin 2003 në Gjeorgji janë mbajtur zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të fituara nga Lëvizja e Bashkuar Kombëtare (më tej "ANN") të kryesuar nga z. Mikheil Saakashvili dhe aplikantin si bashkëpunëtor të tij të ngusht. Ndërmjet viteve 2005 dhe 2012, aplikanti ishte Ministër i Brendshëm, dhe nga korriku deri në tetor 2012, Kryeministri i Gjeorgjisë. Në zgjedhjet e reja parlamentare në 2012, partia opozitare "Gjeorgjia Dream" u zgjodh në pushtet dhe kërkuesi u zgjodh në Sekretarin e Përgjithshëm të Sekretarit të Përgjithshëm të UNM. Kishte një kohë kur filluan procedura penale kundër një numri të ish-zyrtarëve të UNMIK-ut, ish-Presidenti Saakashvili u largua nga vendi dhe vetë kërkuesi u përpoq të kalonte kufirin në aeroportin e Tbilisit duke përdorur një pasaportë të rreme. Aplikanti u arrestua dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kutais urdhëroi ndalimin më 22 maj 2013 për dyshimin për kryerjen e një vepre penale të shpërdorimit të detyrës dhe autoritetit. Aplikanti e kundërshtoi ligjshmërinë e atij paraburgimi, duke argumentuar se qëllimi kryesor i të njëjtit ishte heqja e kërkuesit nga skena politike dhe marrja e informacionit prej tij lidhur me vdekjen e ish kryeministrit dhe llogaritë bankare të ish-presidentit. Ai gjithashtu pohoi se ai u shoqërua fshehurazi nga qelia e burgut gjatë natës së dhjetorit 2013 dhe u dërgua te Drejtori i Administratës së Burgjeve, ku pastaj Prokurori i Përgjithshëm më pas i mori në pyetje çështjet e mësipërme. Më 25 maj 2013, Gjykata e Apelit Kutaisi konfirmoi vendimin e shkallës së parë për paraburgim. Më 17 shkurt 2014, kërkuesi u gjet fajtor për shumicën e veprave penale për të cilat u akuzua, dhe aktgjykimi dhe Gjykata Supreme e konfirmuan atë vendim.

Dhoma e Madhe konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 5 paragrafi 1 në lidhje me arrestimin e ankuesit sepse ishte gjithashtu në përputhje me procedurën e parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale të Gjeorgjisë. Gjithashtu, konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 5 paragrafi 3 në lidhje me vendimin e gjykatës së parë me urdhër ndalimi sepse ishte bazuar në ligj dhe i justifikuar nga ekzistenca e rrezikut të arratisjes dhe ndikimit të dëshmitarëve. Megjithatë, sa i përket një vendimi të mëvonshëm për të vazhduar paraburgimin, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 5 (3) për shkak se autoritetet vendore nuk dhanë një shpjegim të duhur për një vendim të tillë dhe as nuk dëshmonin se ende ekzistojnë arsyet pse është e nevojshme të mbahen parashtruesit në paraburgim. **Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 18 në lidhje me nenin 5 (1) për arsyet në vijim.** Para së gjithash, Gjykata theksoi se neni 18, i ngjashëm me nenin 14 të Konventës, nuk është i pavarur, pasi është plotësuese me nenet e tjera të Konventës ose Protokollat e saj që garantojnë të drejta dhe liri të caktuara.

decisionTitle***decisionDescription***

RASHAD HASANOV AND OTHERS v. AZERBAIJAN (*Applications nos. 48653/13* 07/09/2018)

Aplikuesit janë aktivistë të shoqërisë civile. Ata janë anëtarë të bordit të lëvizjes qytetare NIDA, një organizatë joqeveritare e themeluar nga një grup i të rinjve në shkurt të vitit 2011. Sipas manifestit të saj, NIDA kërkon lirinë, drejtësinë, të vërtetën dhe ndryshimin në Azerbajxhan dhe kundërshton dhunën dhe përdor vetëm ato jo - metodat e dhunshme të luftës. NIDA udhëhiqet nga një bord i anëtarëve të përbërë nga shtatë persona. Kandidatët e parë, të dytë dhe të katërt gjithashtu janë bashkë-themelues.

RASHAD HASANOV
AND OTHERS v.
AZERBAIJAN
(Applications nos.
48653/13 07/09/2018)

6. Në janar dhe mars 2013, një numër demonstratash paqësore u mbajtën në Baku në protestë kundër vdekjes së ushtarëve në ushtrinë Azerbajxhanase në situata jo-luftarake. Demonstratat u organizuan përmes mediave sociale dhe aplikantët dhe anëtarët e tjerë të NIDA morën pjesë aktive në organizimin dhe kryerjen e tyre. Një nga demonstratat ishte planifikuar për në 10 mars 2013 në qendër të qytetit.

Më 7 mars 2013, tre anëtarë të NIDA (S.N., B.G. dhe M.A.) u arrestuan nga agjentët e Ministrisë së Sigurisë Kombëtare ("MNS"). Procedurat e brendshme lidhur me arrestimin dhe paraburgimin e S.N. dhe M.A. janë subjekt i kërkesave të tjera të pazgjdhura para Gjykatës

Ankuesit argumentuan sipas nenit 18 të Konventës se të drejtat e tyre të Konventës ishin kufizuar për qëllime të tjera nga ato të përshkruara në Konventë. Në veçanti, arrestimi dhe ndalimi i tyre kishin pasur për qëllim ndëshkimin e tyre për aktivizmin e tyre politik dhe social si anëtarë të bordit të NIDA, si dhe ndalimin e protestave kundër vdekjes së ushtarëve dhe shkatërrimin e lëvizjes aktive të të rinjve në vend. **Per keto arsye Gjykata unanimisht konstaton se ka pasur shkelje të nenit 18 të Konventës në lidhje me nenin 5 të Konventës;**